

TRASHËGIMIA KULTURORE FAKTOR I NJË ARRITJEJE INDIVIDIALE DHE KOLEKTIVE. LIGJI “PËR TRASHËGIMINË KULTURORE NË KOSOVË” SHPREHJE E DIVERSITETIT DHE TOLERANCËS

Juliana LATIFI

E-mail: julilatifi@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Kuadri ligjor i miratuar tashmë në fushën e trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës në përputhje me standardet ndërkombëtare sjell një risi për rolin dhe rëndësinë që ajo ka, si një shprehje e pazëvendësueshme e pasurisë dhe e diversitetit të trashëgimisë kulturore të Evropës. Miratimi i ligjit nr. 02/L-88 “Për trashëgiminë kulturore në Kosovë” shpreh një vizion të ri në rregullimin e trashëgimisë kulturore dhe vjen si një domosdoshmëri në realitetin që paraqet sot Kosova, ku trashëgimia kulturore e saj duhet të trajtohet si faktor i një arritjeje individuale dhe kolektive e të gjithë popullit të saj, pavarësisht nga etnitë të cilave i përket, sepse ajo është pronë e të gjithëve dhe për të gjithë. Trashëgimia kulturore e Kosovës, si një pasuri e të gjithëve i përket çdo individ dhe komuniteti, ku secili duhet të njohë ndarjen e përgjegjësive për ta mbrojtur atë si në kuptimin fizik ashtu dhe në atë politik.

Fjalë kyçe: trashëgimia kulturore, kuadër ligjor, diversiteti, toleranca

ABSTRACT

The legal framework approved now in the field of cultural heritage in the Republic of Kosovo in the agreement within the international standards bring one *precedence* for the role and

the importance that it has, as well as one expression irreplaceable of the riches and the diversity of cultural heritage in Europe. The approved law no. 02/L-88 “Four cultural Heritage in Kosovo” express the new vision of the regulation of the cultural heritage. It arrives as well as the necessity in the reality that Kosovo has today, where the cultural heritage should treat as the factor of the individual and collective achievement of the people of Kosovo, regardless of ethnics, because it is the property of all for all.

The cultural heritage in Kosovo as well as its treasures belong to every individual and collectively, where everybody should know how to divide the responsibility to protect it, both physically and politically.

Hyrje

Punimi analizon dispozitat ligjore të Ligjit nr. 02/L-88 “Për trashëgiminë kulturore në Kosovë”, që hyri në fuqi në vitin 2007 si dhe referencën e tyre në aktet ndërkombëtare që veprojnë në fushën e trashëgimisë kulturore.

Ky studim, është rezultat i punës time pranë organizmave ndërkombëtare në Kosovë, në bashkëpunim me organizmat vendore, për të përgatitur kornizën ligjore në fushën e trashëgimisë kulturore, në përfaqje me standardet dhe aktet

ndërkombëtare, të cilat sigurojnë një mbrojtje dhe një respektim të vlerave të trashëgimisë kulturore, duke e parë atë si një pjesë të trashëgimisë kulturore të Evropës [1].

Trashëgimia kulturore në Kosovë, si një ndër çështjet më të mprehta të statusit të saj të pavarësisë [2], gjeti rregullim me Ligjin nr. 02/L-88 "Për trashëgiminë kulturore".

Ligji synon të përcjellë mesazhin se kuptimi i njohjes së vlerave të trashëgimisë kulturore është i nevojshëm të vlerësohet në kuadër të një tolerance dhe mirëkuptimi, ku vendosja e një koncepti për një trashëgimi kulturore të përbashkët, përshkon të gjithë frymën e tij, ku trashëgimia kulturore shihet si një e tërë në të gjitha llojet dhe format e shfaqjes së saj", sepse: "... vlerat e trashëgimisë kulturore të krijuar gjatë shekujve... vlera historike dhe kulturore e kësaj trashëgimie është thesar i tërë popullit të Kosovës" (neni 1.1).

Ky parim i sanksionuar në dispozita hyrëse të ligjit, prezanton nevojën/domosdoshmërinë se çdo individ dhe komunitet duhet të njohë ndarjen e përgjegjësive për ta mbrojtur trashëgiminë kulturore, si në kuptimin fizik ashtu dhe në kontekstin politik.

Trajtimi i trashëgimisë kulturore në ligjin e ri, synon t'i bëjë të njohur si autoriteteve përgjegjëse ashtu edhe personave të cilët janë pronarë apo shfrytëzues të objekteve të trashëgimisë kulturore që mbrojtja e saj duhet të bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare, të cilat përcaktojnë hartimin e një strategjie adekuate mbrojtëse. Ligji duke ngarkuar institucionet përkatëse që nga Këshilli i Trashëgimisë Kulturore dhe deri në institucionet në nivel lokal, përcakton qartë, që në njohjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë duhet vendosur në pah uniteti i trashëgimisë kulturore si një e tërë, pavarësisht nga diversiteti kulturor që ajo paraqet.

Kështu, Këshilli i Trashëgimisë Kulturore si organi me i lartë, i cili me përbërjen e tij në të njëjtën kohë prezanton edhe përbërjen etnike në Kosovë (gjë që tregon më së miri diversitetin e trashëgimisë kulturore) "... do të identifikojë çdo vit masat e nevojshme financiare për mbështetjen e trashëgimisë kulturore" (neni 4.9).

Ky Këshill në bashkëpunim edhe me Institu-

cionet e Kosovës, si Ministrinë e Kulturës dhe sidomos me institucionet e specializuara: Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Institutin Arkeologjik, etj., për të realizuar funksionin/detyrat e tij duhet të parashikojnë dhe përcaktojnë hartimin e një strategjie, e cila duhet të përfshijë të gjitha palët e interesuara, si nga shkalla ashtu edhe nga shtrirja e përgjegjësive. Nga ana tjetër, zbatimi i kësaj strategjie do të varet nga efikasiteti i bashkëpunimit nacional dhe lokal/vendor, në politikën e koordinimit, në vigjilencën e pronareve dhe të shfrytëzuesve të objekteve të trashëgimisë kulturore me qëllim të sigurimit të tyre.

Nga ana tjetër kjo strategji krijon një frymë të re në realitetin kosovar ku njohja dhe përdorimi i trashëgimisë kulturore duhet të jetë një faktor i rëndësishëm i një arritjeje individuale dhe kolektive. Çdo vend duhet të shihet në kontekstin e tij historik, social dhe kulturor.

Ligji sjell një frymë të re edhe në pozicionin që duhet të mbajnë pronarët apo personat që shfrytëzojnë objektet e trashëgimisë kulturore, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Këto objekte duhet t'i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, nëpërmjet survejimit të tyre si dhe nëpërmjet aplikimit të programeve të rregullta për të parandaluar rrezikun e tyre nga dëmtimet e mundshme. Kështu në nenin 4.10 të ligjit sanksionohet se: "... secili person fizik dhe juridik ka për detyrë të kujdesët për mbrojtjen e tërësisë së trashëgimisë kulturore nëse ai/ajo është pronar, posedues ose shfrytëzues i kësaj trashëgimie kulturore", dhe nga ana tjetër: "Çdo person që dëmton trashëgiminë kulturore pavarësisht nga marrëdhëniet që ai ka me të, do t'i nënshtrohet sanksioneve përkatëse..." (neni 4.11).

Në tërësinë e tij, ligji prezanton një kompleks përgjegjësish, të cilat gjejnë shtrirje në të gjithë dispozitat e tij për organet publike që veprojnë në fushën e trashëgimisë kulturore, duke i ngarkuar me detyrime konkrete për implementimin e masat që synojnë:

Identifikimin shkencor dhe mbrojtjen ligjore adekuate, sipas përcaktimeve të dhëna në aktet ndërkombëtare dhe pikërisht në Konventat e Grandës [3] dhe të Valetës [4].

- Zhvillimin e një strategjie dinamike të konser-

vimit, duke mobilizuar një potencial ekonomik për një rigjenerim urban dhe një zhvillim rural.

- Kontributin në një shërbim të përgjegjshëm, duke kontrolluar punën në mënyrë të vazhdueshme për ruajtjen dhe konservimin e trashëgimisë kulturore në të gjitha format e shfaqjes së saj.

- Kontributin, me qëllim që marrja e masave të reduktojë rrezikun e kërcënimit të trashëgimisë kulturore. Kur një pronar nuk kujdeset për pronën e tij, e cila ka një vlerë kulturore, atëherë autoritet duhet të ndërhyjnë nëpërmjet marrjes së masave të nevojshme për ruajtjen e saj deri në shpronësim.

- Punësimin e një personeli të kualifikuar për të bërë të mundur që të realizohet një regjistrim dhe një ruajtje.

- Bashkëpunimin për të hartuar një strategji mbrojtjeje duke vënë në jetë veprimtari të mbrojtjes, regjistrimit dhe të nevojave imediate.

- Mbështetjen me një asistencë dhe një orientim edukativ dhe teknik, duke parashikuar projekte të restaurimit dhe të aplikimit të tyre në mënyrë të vazhdueshme.

Ligji duke sjellë një vizion të ri në rregullimin e trashëgimisë kulturore, prezanton impaktin social dhe ekonomik [5] që ajo do të luajë duke ndikuar/influencuar në disa drejtime:

Si një avantazh ekonomik. Standardet e ligjit, lejojnë që kontributi i trashëgimisë kulturore të shihet jo vetëm në të ardhurat imediate në ekonomi dhe në punësimin për një numër të konsiderueshëm aktivitetesh, por si një seri e konsiderueshme e përfitimeve të përbashkëta të komunitetit.

Në procesin e një zhvillimi të qëndrueshëm [6]. Trashëgimia kulturore dhe natyrore sipas ligjit, krijojnë mjedisin e njeriut, dhe të një veprimi të kombinuar për mbrojtjen e përbashkët të tyre, në perspektivë të një veprimtarie ekologjike.

Përdorimi i trashëgimisë kulturore, në kuptim të resurseve të saj, duhet të jetë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, me synimin që këto resurse t'u transmetohen brezave të ardhshëm, duke ruajtur autenticitetin e saj.

Trashëgimia kulturore në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, kërkon që sektori publik dhe

ai privat të kenë përgjegjësi, të adoptojnë praktika të cilat duhet të jenë të përshtatshme dhe të pranueshme me ambientin.

Ruajtja e trashëgimisë kulturore kontribuon më mirë në përcaktimin e mënyrës së prodhimit dhe të konsumit të qëndrueshëm, duke imponuar një veprimtari të ponderuar të hapësirës dhe të burimeve, në një ekonomi të energjisë, të riciklmit të materialeve dhe të shkatërrimit të tyre.

Në strategjinë e qëndrueshme për një turizëm kulturor [7]. Ligji lë të nënkuptuar, që politikat dhe strategjitë e një turizmi kulturor duhet të kërkojnë në perspektivë të një përdorimi të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore, në krijimin e mundësisë së kësaj trashëgimie kulturore për brezat e ardhshëm. Modelet specifike të zhvillimit të turizmit kulturor duhen kërkuar në krijimin e skemave të zakonshme të turizmit për të gjithë. Rritja e turizmit kulturor mund të ndihmojë në zhvillimin dhe të gjallërojë lokalitetin/zonën, ajo ka potenciale të ushtrojë një ndikim në trashëgiminë kulturore dhe influencojë në cilësinë e jetës së komunitetit.

Në nevojën e një strategjie bashkëpunuese [8]. Mbrojtja dhe përdorimi i trashëgimisë kulturore, në ligj kërkon një bashkëpunim dhe angazhim të sektorit publik dhe atij privat për të përcaktuar fatin e ardhshëm të saj. Autoritet kompetente janë të detyruara të zhvillojnë një strategji, e cila do të lejojë asociimin e llojeve të ndryshme të ndërhyrjeve dhe që siguron koordinimin e iniciativës publike dhe privatë me mbështetje të pronareve privatë që kanë në ngarkim sende të trashëgimisë kulturore. Iniciativat ligjore, fiskale dhe administrative mund të mbështeten dhe të implementohen sipas këtyre strategjive.

Gjithashtu, resurset publike, të cilat janë gjithmonë të pamjaftueshëm për të parashikuar mbrojtjen e trashëgimisë kulturore duhet të jenë të mbështetura gjithmonë nga burime të tjera të gjetura.

Nga ana tjetër, strategjia bashkëpunuese kërkon një partneritet të nevojshëm, duke përcaktuar qartë rolin e shtetit dhe të autoriteteve publike të ndryshme, të cilat veprojnë në fushën e trashëgimisë kulturore. Përgjegjësitë respektive, roli i kontrollit, mekanizmi i koordinimit të shtetit dhe të

autoriteteve kompetente duhet të vendosen në një proces decentralizimi. Ndihma në partneritet dhe iniciativa privatë duhen kuptuar si një detyrim dhe përgjegjësi e pushtetit publik në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

Por, pavarësisht nga kompetencat specifike që ka shteti dhe autoritet lokale, roli i organizatave vullnetare [9] duhet të jetë me i favorizuar në përdorimin dhe kurajën që ato kanë në ndërtimin e shoqërisë demokratike, për të cilat ligji nuk shprehet. Ekzistenca e organizatave vullnetare është e rëndësishme në ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërive bazuar në politiken pluralistë demokratike.

Në fushën e trashëgimisë kulturore, organizatat vullnetare kanë aksesin e nevojshëm dhe lehtësirat e mundshme për të monitoruar dhe kritikuar në çdo moment autoritetet publike. Ato duhet të kenë të drejtë në marrjen e vendimeve, sidomos ato vendime të cilat i referohen instancave që janë të lidhura me planifikimin hapësinor dhe seksionin e monumenteve dhe të qendrave të mbrojtura.

Qeveria e Kosovës, duhet të inkurajojë organizatat vullnetare të marrin pjesë aktive në parandalimin e konflikteve duke respektuar diversitetin kulturor dhe duke inkurajuar mbrojtjen e kulturës së të tjerëve.

Në marrjen e masave shkencore dhe edukative për trashëgiminë kulturore dhe edukimi. Ndër masat që parashikon ligji janë studimi, dokumentimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore janë për kërkuesit bashkëkohore dhe të ardhshëm një detyrë parësore, sepse ajo përben një dëshmi të pazëvendësueshme për historinë dhe kulturën e shoqërisë njerëzore.

Sipas frymës së ligjit, pedagogjia e trashëgimisë duhet të nënvizojë vlerat historike, artistike dhe morale që shprehin trashëgiminë kulturore të njerëzimit, duke mësuar respektimin e identiteteve të shumëfishta, zhvillimin e tolerancës dhe të luftës kundër pabarazisë dhe ndalimeve. E nevojshme është që transmetimi i këtyre aftësive të ruajë trashëgiminë kulturore. Kjo mund të asistohet nga shpërndarja dhe shkëmbimi i informacionit dhe ekspertizës me/dhe nëpërmjet shteteve.

Nëpërmjet zbatimit të këtij ligji, synohet të arrihet një pranim **“i arsyeshem”** i njohjes së kulturës dhe të trashëgimisë kulturore [10] të çdo etnie në Kosovë, ku autoritet e Kosovës në nivel qendror dhe lokal duhet:

- Të promovojnë një mbrojtje të integruar të trashëgimisë kulturore duke nënkuptuar një respektim të së kaluarës dhe të tashmes.

- Të bashkëpunojë në hartimin e një politike që favorizon ruajtjen dhe vlerësimin e identitetit të individit dhe të komunitetit.

- Të inkurajojnë liritë në lidhje me pranimin e trashëgimisë kulturore duke respektuar jetën private dhe vlerat kulturore të çdo komuniteti, nëpërmjet një sensibilizimi të opinionit publik në lidhje me diversitetin kulturor.

Këto objektiva do të mund të realizohen nëpërmjet një etike në fushën e strategjisë së trashëgimisë kulturore dhe një rirforcimi të bashkëpunimit në luftë kundër akteve të kundraligjshme që dëmtojnë trashëgiminë kulturore, si dhe nëpërmjet sensibilizimit të komuniteteve të ndryshme, për ndikimin e trashëgimisë kulturore në zhvillimin e qëndrueshëm dhe cilësinë e jetës.

Nga ana tjetër, njohja e diversitetit të trashëgimisë kulturore në nivel lokal dhe nacional, do të krijojë një njohje të identitetit të çdo komuniteti, dhe të mundësive të zhvillimit të Kosovës në konkurrencën ekonomike rajonale dhe me gjërë, nëpërmjet kontributit të dhënë nga ajo vetë, duke krijuar një stabilitet dhe inkurajim të investimeve.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Mungesa e një interesi të mjaftueshëm për ruajtjen dhe konservimin e trashëgimisë kulturore, padyshim shoqërohet dhe me humbjen e pariparueshme dhe me privimin e brezave të ardhshme nga historia e saj.

Në këtë drejtim, të nevojshëm janë rekomandimet të cilat i referohen akteve ndërkombëtare [11], ku qeveria e Kosovës duhet që të marrë të gjitha masat e nevojshme në kuadër të politikës së përgjithshme të mbrojtjes së pasurisë trashëgimore, në rrugë shkencore, nëpërmjet strategjive identifikuese, studimeve, mbrojtjes, konservimit, restaurimit dhe sensibilizimit, të cilat do të mund

të realizojnë:

- Njohjen e kësaj pasurie, e cila është e nevojshme për të evidentuar cilësinë, pasurinë dhe diversitetin e saj.

- Kërkimet që duhet të bëhen, me qëllim që të shihen në mënyrë të unifikuar arkivat e shkruara, grafikët ose fotografitë, publikimet bashkëkohore të veprave si dhe të gjitha gjurmët e tjera, të cilat lejojnë një analizë të thellë, sidomos të ndërtesave arkitekturore [12]. Vendosjen e një repertori sistematik, duke bashkuar në një dokument sistematik çdo produksion, qoftë mbi një repertor nacional i cili mbulon të gjithë epokat, si dhe nga bashkëpunimi i këtij repertori me arkitekturën e shekujve.

Nga ana tjetër, mbrojtja e elementëve më domethënës të kësaj pasurie, do të realizohet në bazë të disa kriterëve të seleksionimit të bëra nga autoritet kompetente duke marrë në konsideratë:

- veçoritë specifike në bashkësinë e stilit, tipit dhe metodës së ndërtimit;

- jo vetëm veprat e autorëve shumë të njohur, por edhe ato më pak të njohura, të cilat identifikojnë arkitekturën dhe historinë e një periudhe dhe japin një vlerësim të evoluimit politik, kulturor, ekonomik dhe social.

Nga ana tjetër, autoritet kompetente në mbështetje edhe të parimeve ndërkombëtare [13], në hartimin e modaliteteve përkatëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore duhet të marrin masa të nevojshme juridike që synojnë:

- zhvillimin e legjislacionit ekzistues në fushën e konservimit të trashëgimisë kulturore, të urbanizmit dhe/ose të ambientit;

- mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore nëpërmjet regjistrimit në listat e mbrojtjes ose futjen e tyre në zonat e mbrojtura;

- përdorimin e një procedure të kontrolluar në zhvillimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;

- plotësimin e legjislacionin për të siguruar një mbrojtje sa më të mirë të trashëgimisë kulturore në të ardhmen.

Po ashtu, autoritetet kombëtare dhe ato lokale/komunale kompetente kanë për detyrë të favorizojnë përdorimin adekuat të trashëgimisë së mbrojtur, që nënkupton një përdorim me qëllim misioni ose muzeologjik ose më në përgjithësi një përdorim ekonomik, komercial ose me një mision banimi.

BIBLIOGRAFIA

1. Convention on the Value of Cultural Heritage for Society (Faro, 2005)

2. Raporti i të dërguarit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për Statusin e ardhshëm të Kosovës M.Ahtisaari. Propozimi gjithëpërfshirës [ërfundimtar për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Trashëgimia fetare dhe kulturore.

3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

4. Convention for the Protection of the Architectural Heritage (Granada, 1985) - CE.

5. Convention for the Protection of the Archaeological Heritage (Valletta, 1992) - CE

6. Declaration on Cultural Diversity on 7 December 2000- Council of Europe

7. Operational Guidelines for the Implementation of the World Heritage. UNESCO for World Heritage-2006

8. Recommendation No. 1/2003 "On the promotion of tourism to foster the cultural heritage as a factor for sustainable development" - Council of Europe

9. Recommendation No. 9/1995 "On the integrated conservation of cultural landscape areas as part of landscape policies" - Council of Europe

10. Recommendation "For the role of non government organisation in the cultural heritage" Portoroz, Slovenia, 5-7 April 2001-Council of Europe

11. World Heritage Convention-1972-UNESCO

12. Recommendation No. 13/1991 "On the protection of the twentieth century architectural heritage" - Council of Europe

13. Recommendation No. 6/1989 "On the protection and enhancement of the rural architectural heritage" - Council of Europe

14. Recommendation No. 5/1989 "Concerning the protection and enhancement of the archaeological heritage in the context of town and country planning operations" - Council of Europe

15. Recommendation No. 3/1995 "On co-ordinating documentation methods and systems related to historic buildings and monuments of the architectural heritage" - Council of Europe